



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/03-1889/23
Kaçanik, 24.01.2023

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **I (parë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 24 janar 2023. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës në mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF ishin 7 anëtarët: Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Fitore Vishi, Kadrije Lika-Troni, Agim Mani, Ardita Rrahmani, Rabije Sallahi.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës- Sabedin Vishi, ndërkaq nga zyrtarët ishte, Mavije Murseli-asistente e Kryesuesit të KK.

Mbledhjen e monitoroj nga OSBE- Faruk Dërmaku.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Procesmbajtës: Makfîre Malsiu- zyrtare për punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e I (parë) të rregullt të KPF-a për vitin 2023, data 24 janar, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e KPF e vitit 2022;
2. Plani i punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2023;
3. Propozim Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm të parcelave kadastrale 00150-0 dhe 00151-0 në ZK Kaçanik, për objektin e SHMU "Emin Duraku" Kaçanik;
4. Draft Plani vjetor i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2023;
5. Raport i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2022;
6. Informatë për Aktivitetin e Kuvendit të Komunës nga Inaugurimi i kuvendit- 08 dhjetor 2021-31 dhjetor 2022.

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: A duhet të shqyrtohen në KPF edhe pikët tjera që janë në rend pune në mbledhjen e muajit janar si: rekomandimet e komisionit, planet e komiteteve, kërkesa e Mirlinda Axhami-Hysa ? Çështje tjetër, Kërkoj me iu përmbajtur afateve ligjore për dërgimin e materialit të mbledhjeve, 7 ditë para mbledhjes.

Kryesuesi i Kuvendit: Pikët që kanë qenë në mbledhjen e kaluar në KK, rekomandimet e komisionit vlerësues nuk kthehen në KPF, Komitetet nuk i raportojnë KPF, as Kërkesa për dorëheqje e Mirlindës nuk ka nevojë me u shqyrtuar në KPF. Të çështja e materialit, ndoshta iu ka ardhur një ditë me vonesë, por nuk ka shumë pikë, ndërkaq për mbledhje të KK materialin e keni me kohë. Rendin e punës e shtroj në votim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e .

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 6 pikëve.

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Kryesuesi i Kuvendit: Vërejtje në procesverbal nuk pati, atëherë Procesverbalin e mbledhjes së kaluar të KPF e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovon

Procesverbalin e mbledhjes së XI (njëmbëdhjetë) të rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) të datës 23.12.2022 / Lënda: Nr. 60/03-33138/22.

2. Planin e punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: Planin është vjetor, ku paraqiten objektivat e ekzekutivit të komunës për gjatë një viti. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë a jeni që kjo pikë t'i shkoj KK? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF

Njoftohet

Me Planin e punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2023 dhe të njëjtin ia përcjellë KK për shqyrtim.

3. Propozim Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm të parcelave kadastrale 00150-0 dhe 00151-0 në ZK Kaçanik, për objektin e SHMU "Emin Duraku" Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Për shkak të problemeve teknike në email, nuk e kam pa materialin i cili na ka ardhur për mbledhje të KK ku është lënda me e kompletuar, ndërkaq në KPF e kemi vetëm propozim vendimin dhe nuk e dimë konkretisht se për çka bëhet fjalë. Nëse ka mundësi kryetari me na dhënë sqarime me në detaje.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Ne e kemi proceduar këtë çështje për miratim, se prona ka qenë jo shumë e definuar, për derisa na ka ardhur një njoftim nga AKP, se është një lloj dualizmi se prona nuk është në pronësi të AKP. Sipas informatave që kemi në dy dokumente të vitit 2009, 2010 nga AKP ka ardhur një njoftim nga AKP për parcelën në fjalë, ne duhet shikuar dokumentet në arkiv se a ka përgjigje. KK me një vendim ka dhënë leje për ndërtimin e shkollës, duke menduar që parcela është e askujt. Në momentin që na ka ardhur një kërkesë për likuidim-shitje të kësaj

parcele, kemi marrë veprimet e nevojshme, pasi që shkolla është e ndërtuar atje, ne kemi kthyer përgjigje reagimit, dhe e kemi proceduar për KK me marrë një vendim, pasi gjendja faktike është ndryshe atje. Pas marrjes së vendimit për shpallje interesi, shkojmë me procedurat të shpronësimit.

z. Agim Mani: Informatat i mora nga ju, ndërkaq për derisa nuk e kam pa materialin, se nuk e di saktësisht për sa sipërfaqe bëhet fjalë, a është krejt pjesa ku është ndërtuar shkolla dhe a po kemi të drejtë me marrë një vendim të tillë, ne në KK e shqyrtojmë më ne detaje.

Kryesuesi i Kuvendit: Unë jam anëtar nga 2009, nuk me kujtohet bash saktësisht, por sa e di unë ka ekzistuar edhe atëherë një vendim i KK.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Vendimi është i KK, por pasi nuk ka pasur pronar, iu ka drejtuar MAPL, ky organ ka kthyer përgjigje pozitive. Është pak e çuditshme në atë kohë qysh kanë ardhur përgjigjet, për derisa ne para 2-3 viteve është gjetur një pronar që pretendon se e ka bërë marrëveshjen në Shkup me KISI, e që tani po del se është jo valide, sepse nuk mundet me u bërë marrëveshja jashtë vendit, ka shumë të paqarta këtu, megjithatë po i marrim këto vendime që sqarohet ku është e vërteta e kësaj. Gjendja aktuale është krejt ndryshe, shkolla është ndërtuar para shumë viteve nga ministria, ministria është financuese se edhe ministria pa pasur dëshmi nuk e kishte ndërtuar shkollën. Tani AKP po thirret që është pronare e asaj prone, kështu që e marrim vendimin derisa nuk bëmë ndeshë me vendimin e cili është marrë më herët.

Kryesuesi i Kuvendit: Unë nuk besoj se gabojmë në këtë drejtim për derisa është në fuqi vendimi i qeverisë që komunat që kanë interes me bërë investime me i marrë pronat e AKP. Ajo pronë është marrë atëherë me vendim të KK, ndërkaq nuk e di pse paskan rrjedhur ato dokumente kështu. Sidoqoftë, ne e plotësojmë edhe me një vendim, nuk ka çka me bërë me tepër për atë pronë se me paguar. Atëherë kur është marrë vendimi nuk ka pasur ndonjë kundërshtim të ligjshmërisë nga ministria.

znj. Ardita Rrahmani: Propozim vendimet kryetar, me njohuritë e mia që i kam, nuk duhet të nënshkruhen e as të vulosën, sepse mbeten vetëm propozim vendime, ndërkaq kur të kthehet në vendime, atëherë duhet nënshkruhen dhe vulosën. Është çështje teknike, por me diskutuar për hera tjera, se nuk i vihet nënshkrim as vulë propozimeve të kryetarit e as të drejtorëve të drejtorive komunale.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne për me ditur saktë nga rrjedh propozim vendimi, e kemi nënshkrimin e organit dhe vulën.

znj. Ardita Rrahmani: Kjo është çështje teknike, për mbledhje të KK do të sigurohem për këtë çështje. Unë e kam prej përvojës time në ministri, ndërkaq mund të jem edhe gabim. Ndoshta dallojnë procedurat e ministrisë me ato të komunave, se unë po foli nga përvoja në ministri, ministrat propozimet kur i kanë dërguar në qeveri, nuk i kanë nënshkruar.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne kemi pasur rast na u është kthyer propozim vendimi se nuk ka qenë i nënshkruar. Kryetari i propozon KK për miratim, ai është vendim i kryetarit dhe nuk mund të procedohet pa nënshkrim dhe vulë në KK, ndërkaq edhe pse është vendim i kryetarit, nuk mundet vendosur vet si organ, por ia dërgon KK për miratim. Propozim vendimet nënshkruhen dhe vulosën në mënyrë që mos me bërë ndokush ndonjë dokument në emër të Kryetarit të Komunës.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Me qenë ashtu qysh po thoni ju Arditë, atëherë çdo kush mundet me bërë shkresa në emër të kryetarit të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë a jeni që kjo pikë t'i kaloj KK në procedurë për shqyrtim dhe aprovim? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e

Aprovoj

Propozim Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm të parcelave kadastrale 00150-0 dhe 00151-0 në ZK Kaçanik, për objektin e SHMU "Emin Duraku" Kaçanik. Ky propozim vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

4. Draft Plani vjetor i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: Meqë ka të bëjë me çështje të sigurisë, ky plan ka ardhur edhe në KPF. Planin e KKSBB e miraton kuvendi. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë a jeni të pajtimit që ky plan të i kalohet KK në procedurë shqyrtimi ? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF u

Njoftohet

Me Draft Planin vjetor të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2023. Ky draft plan i procedohet KK për shqyrtim dhe aprovim.

5. Raport i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Lidhur me aktivitetin e KKSBB, nuk janë publikuar të gjitha procesverbalet e këtij këshilli në faqen zyrtare të komunës. Janë publikuar vetëm procesverbalet për tre mbledhje të vitit 2022 dhe Raporti gjashtëmujor i KKSBB i vitit 2022. Nëse nuk i shohim procesverbalet, ne nuk e dimë për aktivitetin e realizuar të KKSBB në vitin 2022. Ky raport i hartuar është me tepër informatë e jo raport, se nuk ka shumë të dhëna, ndërkaq nëse i shohim edhe procesverbalet, mund të kuptojmë me tepër funksionimin e KKSBB në vitin 2022.

Kryesuesi i Kuvendit: Në kuadër të procedurës, nuk duhet me qenë në shqyrtim procesverbalet, por raporti i KKSBB. Në raport shënohet aktiviteti i realizuar në formë të shkurtër, ndërkaq nëse nuk janë publikuar procesverbalet, atëherë kenë arsye.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Nëse ka pasur ndonjë problem me faqen zyrtare, mund të ketë ndodhur që nuk është bërë publik ndonjë procesverbal, se çdo herë janë publikuar të gjitha procesverbalet e KKSBB. E marrë në konsideratë këtë çështje, përgjigjen ua jap në mbledhje të KK.

z. Kadri Krivenjeva: Pyetje për kryetarin: A ka ndonjë informacion rreth çështjes se ujit të pijes, a duhet me vluar ujin e pijes para se me pirë ? Këtë pyetje po e parashtroj, pasi që çështja e ujit të pijes bërë problematike në disa komuna për shkak të reshjeve atmosferike.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Meqenëse të ne reshjet atmosferike kanë qenë me të vogla, është Instituti që na jep rekomandime të tilla, por deri me sot nuk kemi ndonjë rekomandim, edhe pse për çdo javë bëhen analizat mikrobiologjike të ujit, por deri me tani nuk kemi ndonjë

rekomandim të tillë. Në momentin që na vjen diçka nga instituti, atëherë ne i marrim veprimet tona të nevojshme dhe i njoftojmë qytetarët.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë a jeni që kjo pikë t'i kaloj KK në procedurë për shqyrtim? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF

Njoftohet

Me aktivitetin e KKSBB për vitin 2022 përmes Raportit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2022. Raporti i kalohet KK në procedurë shqyrtimi.

6. Informatë për Aktivitetin e Kuvendit të Komunës nga Inaugurimi i kuvendit- 08 dhjetor 2021- 31 dhjetor 2022:

Kryesuesi i Kuvendit: Informata për aktivitetin e KK është hartuar në vija të trasha nga zyrtarja e KK, ku është bërë një përmbledhje e aktiviteteve. Për me gjerë janë procesverbalet e mbledhjeve të KK. E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: A duhet të votohet në KK kjo informatë apo jo? A votohet Plani i KKSBB dhe Raporti i KKSBB? Këto pyetje po i bëjë, sepse ka pasur raste kur është votuar një çështje, e cila është dashur me kaluar si informatë.

Kryesuesi i Kuvendit: Informata për aktivitetin e KK nuk votohet. Plani i KKSBB votohet, ndërkaq Raporti i KKSBB nuk votohet. Kur çështjet nuk janë të definuar, ndodhë edhe që votohen, se ka komuna që i votojnë. Diskutime të tjera nuk ka, a jeni që kjo informatë t'i shkoj KK në procedurë? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF

Njoftohet

Me Aktivitetin e Kuvendit të Komunës, përmes dokumentit, Informatë për Aktivitetin e Kuvendit të Komunës nga Inaugurimi i kuvendit- 08 dhjetor 2021-31 dhjetor 2022. Kjo Informatë i kalohet KK në procedurë njoftimi.

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu e konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora: 11:30. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët e KPF që ishin prezentë në këtë mbledhje. Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 31 janar 2023 në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfije Malsiu

Malsiu



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Murseli